



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Drejtoria për Arsim



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje



-IV- Nr. I prot. 510 Më Dt. 05.10 2022
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimi i përkohshëm, nenit 84 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, dhe rekomandimit të Komisionit të rekrutimit për vendet e punës drejtor dhe zëvendësdrejtor në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Rahovecit Nr. 509 i datës 04.10.2022, Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit bënë këtë:

N J O F T I M

Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit bën anulimin e konkursit Nr. 04/385 të datës 15.07.2022 të ri shpallur nga Drejtoria për Arsim, në web-faqen e Komunës së Rahovecit, për titullin e vendit të punës Drejtor/eshë në IAAP "Selajdin Mullaabazi - Mici" në Rahovec.

Anulimi i konkursit të lartpërmendur bëhet për shkak se kandidatët të cilët kanë konkurruar në këtë konkurs, pas intervistimit nuk i kanë plotësuar standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave, duke mos arritur minimumin e nevojshëm të pikëve gjatë intervistimit, bazuar në formularët e vlerësimit të hartuara nga komisioni dhe të pasqyruar në formularin "D", siç parashihet në Udhëzimin Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimi i përkohshëm.

Rishpallja e konkursit do të bëhet në afate ligjore.

